



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## Njoftim

Autoriteti i Likuidimit, në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit njofton për anulimin e tenderëve të publikuar më datën 21.12.2020, me numër të referencave: AKP-AL 001 me titull “Matjet për Parcelat Kadastrale që administrohen nga AKP” dhe AKP-AL 002 me titull “Zhvillimi i sistemit kadastral për AKP”.

U Anulimi i tenderëve është bërë nga ana e Autoritetit të Likuidimit në konsultim me menaxhmentin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit më datë 06.01.2021, për këto arsye:

- a) Duhet të bëhet rishikimi i dosjes së tenderit dhe hapave tjerë procedural të cilët duhet të bazohen në Udhëzuesin Nr.1/2009 Për Komisionet për Likuidim mbi Procedurat e Prokurimit Duke Shfrytëzuar Fondet e Likuidimit në Mirëbesim dhe jo në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;
- b) Në bazë të nenit 3, paragrafit 7 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, përjashtohet aplikimi i këtij Ligji në rastin e këtyre tenderëve, duke marrë parasysh faktin që financimi i tenderëve të shpallur më datë 21.12.2020 bëhet nga ana e fondeve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim dhe në lidhshmëri me Nenin 2, paragrafin 2.8 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, fondet që mbahen në mirëbesim nga ana e Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim e që janë nën Menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk konsiderohen si “para publike”. Si rrjedhojë, ky aktivitet i prokurimit nuk i nënshtrohet Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik;
- c) Ankesat eventuale të parashtruara ndaj tenderëve të shpallur janë shqyrtuar dhe janë marrë parasysh në marrjen e këtij vendimi.

Për çdo informatë shtesë në lidhje me hapat e ardhshëm do të njoftoheni me kohë.

Bajram Sherifi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit

Albert Matoshi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit